



Ju mund të kenë një sëmundje Cerebrovaskulare; një sërë mosfunksionimesh të trurit lidhur me furnizimin e tij me gjak. Duhet të vizitoheni fillimisht nga një kirurg vaskular përpara së të përballoni komp-

likacione serioze neurologjike, të cilat mund të zvogëlojnë në mënyrë të ndjeshme cilësinë tuaj të jetës ose edhe të krijojnë komplikacione kërcënuese për jetën. Arteriet Karotide dhe ato Vertebrale janë enët kryesore të gjakut për furnizimin e trurit. Ato duhen kontrolluar menjëherë nëse kenë një apo më shumë nga shqetësimet e mësipërme.



Nëse kenë VARIÇE, enjtje, dhimbje barku dhe/ose rëndesë në këmbët tuaja ose nëse nuk e pëlqeni ngjyrën blu/lejla të enëve të gjakut në gjymtyrët tuaja duhet të kenë gjithmonë parasysh që ekzistojnë zgjidhje të ndryshme për këto probleme; skleroterapi, terapi me shkumë ose trajtime me lazer. Megjithatë ka raste kur kirurgjia është e pashmangshme.

SPITALI AMERIKAN QENDRA VASKULARE PROGRAMI PËRZGJEDHËS

90 % e sëmundjeve dhe vdekshmërisë të lidhur me sistemin vaskular e kanë origjinën nga sistemi cerebrovaskular, aorta abdominale dhe nga arteriet periferike. Për këtë arsye kemi përgatitur një program përzgjedhës mjaft specifik për vlerësimin e problemeve të lartpërmendura. Ky program përzgjedhës është shumë i shpejtë dhe i lehtë dhe shërben për vlerësimin e rrezikshmërisë ndaj:

- Aneurizma e Aortës Abdominale
- Sëmundjet e Arterieve Periferike
- Sëmundjet e Arterieve Karotide

Spitali Amerikan

www.spitaliamerikan.com

facebook.com/spitaliamerikan

Shërbim Urgjence 24h

Shërbime Laboratorike

Kardiologji

Kardiokirurgji

Kirurgji e Përgjithshme

Kirurgji Plastike

Ortopedi

Gastroentereologji

Otorinolaringologji

Obstetrikë - Gjinekologji

Fertilizim In Vitro

Pediatri

Neonatalogji

Neurologji

Nefrologji

Urologji

Onkologji

Hematologji

Anatomopatologji

Endokrinologji

Reumatologji

Pneumologji

Alergologji

Dermatologji

Okulistikë

Farmaci

Imazheri e Avancuar

- Rezonancë magnetike

- Skaner 64 dedektorë

- Shintigrafi

- Mamografi

- Densitometri e kockës

Spitali Amerikan 1

042 35 75 35

LAPRAKË

Rruga "Lord Bajron" pranë SUQU. - Tiranë

Spitali Amerikan 2

042 36 66 63

RRUGA E DIBRËS

pranë Fakultetit të Mjekësisë - Tiranë

American Medical Center Durrës | 052 22 23 33

Lagjia 18. Rruga "Ahmet Ramzoti" - Durrës

American Medical Center Fier | 034 23 21 23

Lagjia 1 Maji, Rr. Çamëria - Fier

Spitali Amerikan Prishtinë | 038 221 661

Hajvali, Km. 7 - Prishtinë



Spitali Amerikan

QENDRA VASKULARE



Sëmundjet e trajtuara në Qendrën Vaskulare

SËMUNDJE TË ENËVE TË GJAKUT TË ZEMRËS
SËMUNDJE CEREBROVASKULARE
SËMUNDJE TË ARTERIEVE ANËSORE
SËMUNDJE VENOZE

QENDRA VASKULARE E SPITALIT AMERIKAN POSEDON JO VETËM NJË STAF TË GJERË DHE TË SPECIALIZUAR PËR TRAJTIMIN E GJITHË SËMUNDJEVE VASKULARE, PRA TË ENËVE TË GJAKUT, POR EDHE APARATURAT MË TË AVANCUARA TË TEKNOLOGJISË SË LARTË QË PËRDOREN NË DIAGNOSTIKIMIN E TYRE.

Mbas një ekzaminimi të trupit të kryer nga një prej specialistëve tanë mund t'ju nevojiten ekzaminime të mëtejshme si psh; ultrasonografi doppler, angiografi me Tomografi te Kompjuterizuar, Rezonancë Magnetike ose Angiografi Konvencionale DSA. Spitali Amerikan gëzon reputacionin e të vetmit spital në vend që mund të performojë të gjitha sa më sipër si edhe terapitë invazive të nevojshme në fushën e sëmundjeve vaskulare. Pas përcaktimit të problemit tuaj, vendoset në mënyrë të menjëhershme një trajtim i posaçëm.

Mundësitë kryesore për trajtimin e problemeve të enëve të gjakut janë:

- trajtimet mjekësore me medikamentet më të fundit
- procedurat invazive; aplikimet e unazës dhe balonit ose procedura të tjera endovaskulare
- ndërhyrje e mirëfilltë kirurgjikale



ANEURIZMA E AORTES ABDOMINALE

Është një sëmundje e fshehtë e cila shkakton probleme kërcënuese për jetën. Zgjerimi i lokalizuar i aortës abdominale është i njohur si aneurizëm e aortës abdominale. Komplikacioni më shqetësues i kësaj sëmundjeje është çarja e aortës. Që në momentin që gjaku rrjedh në abdomen, njerëzit të cilët preken nga çarja e aortës në shumicën e rasteve vdesin përpara se të mberrijnë në një qendër mjekësore. Aneurizma e Aortës Abdominale është një sëmundje shumë e fshehtë. Shumica e rasteve të kësaj sëmundjeje diagnostikohen vetëm gjatë një kontrolli rutinë. Për këtë arsye rëndësia e kontrollove rutinë nuk duhet nënvlerësuar. Në varësi të simptomave dhe të diametrit të aneurizmës, sëmundja mund të trajtohet me anë të kirurgjisë së hapur ose me anë të teknikës endovaskulare. Vitet e fundit teknika endovaskulare është përgjithësisht më e preferuar nga vetë pacientët.

SËMUNDJET OKLUZIVE TË ARTERIEVE PERIFERIKE

(pamjaftueshmëria arteriale ose ishemia)

Nëse keni dhimbje ose ngërç në pulpën e këmbës ose në vithe gjatë ecjes, gjë e cila ju bën të ndaloni, një nga arteriet e këmbës tuaj mund të jetë e bllokuar. Kjo lloj dhimbje është quajtur "CLAUDICATION". Ateroskleroza, sëmundja e Buerger-it ose veprimtaritë e koagulimit mund të jenë shkaktarë të këtij problemi. Në një fazë më të avancuar të sëmundjes së patrajtuar, fillon e bëhen të dukshme plagë të rrezikshme në këmbët tuaja. Shërimi i këtyre plagëve është shumë i vështirë, ato konsiderohen si lajmëtare përsa i përket zhvillimeve të mëtejshme të gangrenës. Në qendrën tonë ju ofrojmë gjithë mundësitë për diagnostikimin dhe ndjekjen saktë të këtyre problemeve. Nëse keni shqetësime apo dhimbje mos lini pas dore një kontroll të specialistit.

SEMUNDJET FUNKSIONALE ARTERIALE

- Nëse jeni intolerant ndaj të ftohtit.
- Nëse keni dhimbje në duar dhe këmbë gjatë motit të ftohtë.
- Nëse gishtat ju bëhen lejla kur ekspozohen ndaj të ftohtit
- Nëse këmbët dhe duart tuaja djersijnë shumë

Nëse një apo më shumë nga simptomat sa më sipër është diçka që ju shqetëson ju mund të keni një Sëmundje Funktionale Arteriale. Mos lini pas dore takimin tuaj me mjekun e Qendrës Vaskulare për të kuptuar si qëndron problemi dhe gjetur zgjidhjen e shqetësimit tuaj.

SEMUNDJET CEREBOVASKULARE

Nëse keni një nga simptomat e mëposhtme:

- dobësi në fytyrë
- dëmtime të shikimit
- humbje ekuilibri
- dhimbje koke të papritur
- konfuzion mental të shoqëruar më të folur të pakuptimtë
- marrje mendsh, paqëndrueshmëri, përzjerje, të vjella
- shqetësime me gjuhën që shkakton probleme në të folur
- vështirësi në qëllitje, mpirje
- debulesë nga humbja e tonit postural